

Brazil 2014/ Qipro – Shqiperi 0-0

nga AlbaniaSoccer
E martë, 15 Tetor 2013 22:29



Ka perfunuar me nje barazim te shemtuar ne Nikosia aventura kuqezi ne misionin qe nisi me shume endrra dhe perfundoi me nje realitet shqiptar qe e kemi pare shpesh. Shqiperia barazoi ne Qipro perballe vendasve me nje rezultat te bardhe 0-0. Nje ndeshje e dobet pa shume nerv ishte e justifikueshme pasi perballe ishin skuadra te vendit te peste dhe vendi I gjashte ne grupin E, dy ekipe te dorezuara ne luften per nje objektiv. Shqiperia e De Biazit nje skuader flegmatike nuk beri dot ate qe pritej, te merrte nje fitore minimale ne transferte. Salihi, Rama dhe Roshi humben disa raste per shenim nderkohe qe edhe qipriotet paten mundesite e tyre por Berisha ishte si gjithmone pozicional. Ne fund, te dy skuadrat jane larguar nga fusha me koken ulur pas nje edicioni qe perfundoi me zhgenjim.